

Annex F: Përshkrimi i Pronave të Konfiskuara nga Krimi i Organizur, subjekt i Thirrjes për Projekt-Propozime

1-“Truall” me sip. 470 m² dhe magazine 48 m² mbi këtë truall lagja “Çlirimi “Lushnje.

Pasuria përbëhet nga: truall me sipërfaqe 470 m², garazh me sipërfaqe 24 m² dhe magazinë me sipërfaqe 48 m². Ajo ndodhet në anën perëndimore të rrugës Çlirimi, rreth 700 m në perëndim të qendrës së qytetit të Lushnjës. Vendndodhja e saj është në një pozicion të favorshëm me rrugë të mira komunikimi duke qenë se përpara objektit ndodhet një shesh i madh pallatesh. Pasuria truall është e rrethuar në të katërta anët e saj me mure me bllok betoni (20 cm) dhe lartësi prej 2.5 m. Që prej vitit 2010 pasuria e konfiskuar është nën administrimin e AAPSK. Pasuria ka nevojë për rikonstrukcion. [Planimetria.](#)

Foto të pasurisë



2-“Garazh” me sip. 48.1 m² në Sarandë.

Pasuria –“Garazh” me sip. 48.5 m² gjendet në katin përdhe të pallatit dhe është e përshtatur si apartament. Dera e jashtme e blinduar, dyshemeja e shtruar me pllaka, dera e dhomës prej druri, dera e tualetit dur-alumin, dritaret dur alumin, instalimet elektrike te rregullta. Që prej vitit 2005, pasuria e konfiskuar është nën administrimin e AAPSK. Pasuria ka nevojë për rikonstrukcion. [Planimetria](#).

Foto të pasurisë



